



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.11/01-21-945, të datës 03.06.2019), duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës, me qellim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 nr. 011-21952 të datës 03.06.2019 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale dyqanet , me datën 28.05.2020 rishpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale-dyqanet

Ftohen të gjithë të interesuarit personat fizik dhe juridik që të aplikojnë për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër 20 pronat e paluajtshme-dyqanet të cilat janë në pronësi të Komunës së Gjakovës.

Pronat e paluajtshme që do të jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes njoftimit publik në afat prej 5 viteve në zonën I dhe II ndërsa prej 10 viteve në zonën III janë dyqanet si në vijim:

Zona I

	Adresa	Nr. Njesisë	Sipërfaqja	Çmimi fillestar m ²
1	Rr. Marin Barleti	1003-0-23-2-2-0	35 m ²	6€
2	Rr. Bardhyl Çausi		11.9 m ²	6€
3	Rr. Mbretëresha Teuta	1003-0-23-2-1-0	53.0 m ²	6€

Zona II

	Adresa	Nr. Njesisë	Sipërfaqja	Çmimi fillestar m ²
1	Rr. Anton Qeta	5109-1-42-3-4-0	46.9 m ²	2. ⁵⁰ €
2	Rr. Anton Qeta	5109-1-42-2-2-0	48.5 m ²	2. ⁵⁰ €
3	Rr. Anton Qeta	5109-1-42-1-1-0	24.0 m ²	2. ⁵⁰ €
4	Rr. Anton Qeta	5109-1-42-1-2-0	25.0 m ²	2. ⁵⁰ €
5	Rr. Anton Qeta	5109-1-42-2-1-0	51.5 m ²	2. ⁵⁰ €

Zona III

	Adresa	Nr. Njesisë	Sipërfaqja	Çmimi m ²
1	Rr. Marin Barleti	122-1-2-0	28.8 m ²	0. ⁵⁰ €
2	Rr. Marin Barleti	122-1-3-0	19.9 m ²	0. ⁵⁰ €
3	Rr. Marin Barleti	122-1-4-0	23.2 m ²	0. ⁵⁰ €
4	Rr. Marin Barleti	122-1-6-0	11.4 m ²	0. ⁵⁰ €
5	Rr. Marin Barleti	122-1-8-0	13.8 m ²	0. ⁵⁰ €
6	Rr. Marin Barleti	122-1-9-0	32.1 m ²	0. ⁵⁰ €
7	Rr. Marin Barleti	122-1-10-0	19.8 m ²	0. ⁵⁰ €
8	Rr. Marin Barleti	122-1-5-0	16.4 m ²	0. ⁵⁰ €
9	Rr. Marin Barleti	122-1-7-0	20.8 m ²	0. ⁵⁰ €
10	Rr. Marin Barleti	122-1-11-0	30.0 m ²	0. ⁵⁰ €
11	Rr. Shefki Shasivari	1073-0	56.0 m ²	0. ⁵⁰ €
12	Rr. Shefki Shasivari	1074-0	40.0 m ²	0. ⁵⁰ €

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:

- Përfitimi ekonomik i Komunës përmes qiradhënies;
- Funkcionalizimi i dyqaneve.

Kushtet e veçanta:

- a) Aplikuesit mund të konkurrojnë vetëm për një dyqan;
- b) Ndalohet shfrytëzimi i dyqaneve nga palët e treta;
- c) Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit me të lartë të ofruar si dhe kritereve të përcaktuara në këtë njoftim publik;
- d) Vlera e çmimit fillestar është vendosur nga komisioni ndërsa aplikuesit përcaktohen për çmimin;
- e) Pagesa e të gjitha komunalive që ndërlidhen me dyqanet, i bartë përfituesi-shfrytëzuesi;
- f) Përgjegjësit e investimit, renovimit, rregullimit i bartë përfituesi-shfrytëzuesi;
- g) Shfrytëzimi i hapësirave të jashtme duhet të miratohet paraprakisht nga DUM-i, në bazë të rregullores për shfrytëzimin e hapësirave të jashtme;
- h) Orari i punës të jetë sipas rregullores komunale në fuqi;
- i) Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të komunës dhe fituesit (shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të komunës).

Kushtet e përgjithshme të njoftimit publik:

1) Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore vlejné për (bizneset ekzistuese) ;
- Vërtetimin e tatimit në Pronë;
- Vërtetimin e tatimit në biznes vlejné për (bizneset ekzistuese);
- Të ofroj dëshmitë financiare (si p.sh. Deklarata nga banka, kapitali vetanak, etj.)

Vërejtje: Dosjet te cilat nuk janë të kompletuara sipas kushteve të përcaktuara në këtë njoftim publik nuk do të shqyrtohen, do të konsiderohen si të pavlefshme.

- 2) **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në ueb – faqen e Komunës. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë “ *Komisionit për ankesa*” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës së Gjakovës.

Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.

- 3) **Periudha e vlefshmërisë së njoftimit publik do të jetë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.**
- 4) **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimit në katin përdhese , 1 origjinal dhe 2 kopje, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.

Kryesues i Komisionit



Ferdinand Kolaj